



PROCESVERBAL

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 9 (nëntë) të rregullt për vitin 2026, të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi:	Suharekë
Zyra:	Salla e Kuvendit të Komunës
Data:	31.08.2026
Ora:	10:00

Prezentë në takim:

Znj. Sanie Kuçi
Rexhepaj

Z. Flamur Bytyçi

Znj. Doruntina Zenelaj

Z. Urim Suka

Z. Astrit Salihu

Z. Nexhat Ramadani

Znj. Vlorë Kryeziu

Znj. Dafina Kolgeci

Z. Bexhet Kuçi

Znj. Albulena Kokollari

Z. Edon Sadikaj

Z. Aziz Bytyçi

Znj. Mimoza Bajraktari

Z. Enver Shabani

Znj. Besa Kuçi

Z. Syl Zenelaj

Z. Ilir Voci

Z. Dardan Berisha

Z. Labinot Halitjaha

Znj. Merita Basha

Z. Demokrat Vataj

Znj. Afërdita Morina

Znj. Antigona Zyba

Z. Liridon Fandaj

Z. Qëndrim Elshani

Znj. Laureta Tafaj

Znj. Jehona Rrafshi

Lumi

Të pranishëm tjerë:

Kryetari i Komunës

Media dhe qytetarë

OSCE, LMT, KDI

Znj. Habibe Bytyqi

Z. Xheladin Sadikaj

Takimin e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z.Bexhet Kuçi,i cili i njoftoi me rendin e ditës.

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për drejtorë të shkollave;
4. Rishqyrtimi i vendimit 01-Nr-016-28760 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;
5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit Plani Rregullues i Hollësishëm për „Zonën Ekonomike në Duhël“;
6. Shqyrtimi i projekt-vendimit paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;
7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen qytetar nderi;
8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit lokal të veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunën e Suharekës;
9. Pyetje dhe përgjigje;

Kryesuesi - e hedhë në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedhë në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi - e laboron pikën dhe hap debatin.

Dardan Berisha - përgëzoi komisionin për punën e bërë. E kemi diskutuar edhe në KPF dhe rëndësia e kësaj pike është që të ulët vlera e tarifës sepse po i bie shtrenjtë me pagu familjeve. Kërkoj që organet përgjegjëse të cilat janë për uljen e kësaj tarife, me sjell në kuvend një projekt-vendim dhe këto banesa me vazhdu me i dhënë ashtu siç iu kemi dhënë të tjerëve sepse po i bie një lloj diskriminimi.

Flamur Bytyçi - në emër të grupit të LDK-së e përkrahim këtë projekt-vendim. Ashtu siç e kemi diskutuar edhe në KPF mbetet edhe shqetësimi i joni që kjo kategori e këtyre shfrytëzuesve të trajtohet siç janë trajtuar rastet e mëparshme andaj kërkoj nga ekzekutivi që ta gjej një zgjidhje që të jenë të gjithë të barabartë qysh kanë qenë dhëniet në shfrytëzim herën e kaluar.

Aziz Bytyqi - në emër të grupit e vlerësoj punën e komisionit dhe vlerësoj kërkesën që ajo taksë prej 1 euro në meter katror me u heq.

Laureta Tafaj - ne e mbështesim këtë pikë. E njëjta vlen edhe nga unë sa i përket tarifës prej 1 euro por në KPF është diskutuar se nuk mund të bëhet më pak për shkak të zonës në të cilën gjenden mirëpo ne duhte me gjet një zgjidhje që me heq krejt, me fal atë qera.

Kryesuesi - shqetësimet që i paraqiten shefat e grupeve edhe unë jam për që me pas një mundësi me heq këtë shumë sepse është ngarkesë e madhe për familjet e dëshmorëve. E hedhë në votim pikën 2.

Unanimisht Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për drejtorë të shkollave;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - ne i japim mbështetje që ky komision të formohet me të vetmen ide që këto shkolla ti kenë drejtorët e tyre dhe të menaxhohen sa ma mirë. Për deri sa po diskutojmë për këtë pikë,në emër të grupit shpreh shqetësimin për vonesën në emërimin e drejtorëve në këto shkolla.Shqetësim të tillë kemi pas edhe në konkursin paraprak ku ka pas shumë vonesa.

Kryesuesi - e hedhë në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet pika 3

Pika 4. Rishqyrtimi i vendimit 01-Nr-016-28760 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Nexhat Ramadani - unë nuk kam diçka thelbësore ose me kundërshtu por shqetësuese është për shkak se po na përsëriten këto dukuri. Edhe mbledhjen e kaluar ne i kemi pas dy vendime për rishikim. Nuk ka mbledhje që nuk vje vendim për rishikim dhe unë e di që ndonjëherë ndodh ndonjë gabim por kjo është e pakuptimtë. Ne si grup parlamentar kemi shqetësim dhe e kemi thënë edhe më herët që të jeni më të përgjegjshëm kur përgaditen këto projekt-vendime. Megjithatë ne nuk jemi kundër këtij vendimi.

Kryesuesi - ne shumë herë kemi miratu vendime për me dhënë prona në shfrytëzim por asnjëherë nuk është kërku me cek por tash po e kërkojnë me cek dhe ne duhet me vepru në bazë të kërkesës së tyre.

E hedh në votim pikën 4.

Unanimisht Miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit Plani Rregullues i Hollësishëm për „Zonën Ekonomike në Duhël“;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Sanie Kuçi Rexhepaj - është njëra ndër pikat më të rëndësishme të kësaj mbledhje për nga pesha e vendimmarrjes, një dokument që është prit gjatë sidomos prej bizneseve.Normal që si grup jemi përkras të këtij projekt-vendimi por nuk mundem pa u ndal me dhënë kritikë për vonesat që janë shkaktu.Mandatin e kaluar e kemi diskutu një pike të tillë të rendit të ditës dhe kemi kërku që gjatë hartimit me u mbajtë më shumë diskutime publike me biznese.Sipas jush atëherë ka qenë i gatshëm ai dokument me dale në shqyrtim publik por mandej u dashtë një vit kohë për me ardhë në asamble.Në diskutimin publik që është mbajtë në maj kam qenë prezent dhe i kam diskutu disa çështje dhe dua ti ngris edhe në kuvend që ekipi komunal i komunës por edhe kompania hartuese me i pas parasysh për deri sa është draft dhe mund edhe ti shqyrtojnë.Kam kërku që rreth e rreth zonës industriale me u shqyrtu mundësia që me pas më shumë gjelbërim në mënyrë që absorbu ndotësit.Gjithëashtu kam kërku që me u respektu zona mbrojtëse e autostradës për shkak se 4 apo 5 parcela po preken nga kjo zonë mbrojtëse e autostradës.Në atë zone mbrojtëse të autostradës nuk ke të drejtë ndërtimi dhe disa parceala po përgjysmohen nga ajo padrejtësi.Nga arsyetimi i kompanisë në diskutim publik tha që ajo pjesë mundet me u shfrytëzu për parkingje dhe për gjelbërim.Në rregull është por duke marrë për bazë indeksin e shfrytëzimit të parcels që është 50% e parcels mundet me u ndërtu,atëherë në7.5 ari ai nuk ka mundësi me shfrytëzu atë përqindje për shkak se tri anët duhesh me u largu nga fqinjët.Në këtë formë po kërkoj nga ekipi dhe kompania që atë zone me e rishqyrtu ose me i bashku,me kriju hapësirë më të madhe.Gjithëashtu te pjesa tekstuale faqe 17.18 dhe 19 janë disa çështje që po bien në kundërshtim me zonën që jemi duke e diskutu.Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale është 45 % maksimumi por nëse e shohim dokumentin thotë që është 50%.Gjithëashtu kërkesat minimale për vendparkingje thotë që është minimum një vend parking për 100m² por në pjesën tabelare shkruan dy vendparkingje për 100m² dhe janë në kundërshtim njëra me tjetrën.Faqe 19 tekstualisht shkruan që të gjitha objektet e banimit duhet të dizajnohen dhe të ndërtohen sipas standarteve që i përgjigjen nevojave të personave me aftësi të kufizuar.Ne nuk po flasim për ndërtesat e banimit por po flasim për një zonë industrial ekonomike.Faqe 17 gjerësitë e rrugëve,ne jemi duke fol për një zone të caktuar por këtu kur marrim dhe shohim gjerësitë e rrugëve jemi duke fol për rrugën “Xhavit Syla”,rr.”Hajdin Berisha”,rr.”Skënderbeu”,rr.”Besim Ndreca” që janë rrugë në zonën urbane dhe nuk janë në zonën ekonomike dhe nuk e shoh të arsyeshme brenda përbrenda pse duhet me i pas ne këto të dhëna për derisa neve nuk na hyjnë në punë.Autoriteti përgjegjës komunal mund edhe të aplikoj bonuset e zonimit përgjat përpjekjeve për të zbatuar vijën rregulluese planifikuese konform rregullores për bonus zonim e që neve nuk na duhen bonuset e zonimit në zonën ekonomike për shkak se rrugët janë tërësisht publike

dhe nuk kemi pse me bo këmbime për deri sa është pronë e jona. Sa do që mundet me u diskutu bonusi i zonimit në këtë rregullore, duhet me u specifiku qartë pse janë duke u parapa bonuset e zonimit në këtë zone. Në diskutimin publik që është mbajtur në maj, përfaqësuesit e INS-it thane që mundet përmes partneritetit publiko-privat por që në dokument nuk gjen asgjë të partneritetit publiko-privat dhe arsytimit që e dha përfaqësuesi i INS-it por gjejmë çështje që lidhen me banim dhe me rregullim të rrugëve. Për rregullim të rrugëve ose për të rritur hapësirat e hapura dhe sipërfaqet e gjelbërta, ne nuk kemi nevojë me i rrit hapësirat e gjelbërta në zone industriale sepse jemi duke i planifikuar me kohë dhe prona është publike. Për të ofruar përmirësim të trafikut dhe lëvizje të këmbësorëve. Nuk na duhen bonuset e zonimit për rrugë dhe këmbësor për shkak se jemi duke i planifikuar me kohë në prona publike. Për të ruajtur sipërfaqet kulturore dhe historike. Nuk na duhet me i ruajtur sipërfaqet kulturore dhe historike për shkak se nuk ka në atë zonë as çështje kulturore dhe as historike. Për të ruajtur token bujqësore; Nuk kemi tokë bujqësore brenda kësaj zone. Për të krijuar ndërtesa dhe hapësira publike dhe sociale për të cilat përfiton komuniteti. Nuk kemi me kriju për shkak se jemi duke planifikuar me bo dhe prona është publike. Për të përmirësuar vendbanimet joformale; Nuk kemi vendbanime joformale në zone industriale. Pra janë disa çështje që nuk po lidhen me zonën industriale dhe duhet me u potencu saktësisht pse bonuset e zonimit kanë me u aplikuar në këtë zonë. Te projekt-vendimi neni 2 konsultimet publike thotë: Projekt-dokumenti i cekur në nenin 1 të këtij vendimi u lihet në dispozicion për shqyrtim publik: grupeve të interesit, qytetarëve, agjencive, departamenteve dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komentim në afat prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e pare vijuese pas konfirmimit të ligjshmërisë dhe hyrjes në fuqi të këtij vendimi. E pata një paqartësi për shkak se është edhe një udhëzim administrative për shqyrtim publik të dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe në atë dokument kërkon që komuna me bo thirrjen përmes një dokumenti dhe pastaj kur të ceket prej cilës date fillon shqyrtimi publik dhe cilën date përfundon, mundet edhe më shumë se 30 ditë sepse nuk është e kufizuar dhe pastaj brenda asaj thirrje caktohet edhe dita e prezantimit të dokumentit.

Laureta Tafaj - pyetje për kolegen. A mund të tregosh edhe një herë për pjesën e destinuar për parkingje për persona me aftësi të kufizuara.

Sanie Kuçi Rexhepaj - disa çështje në këtë dokument janë kopë paste nga HZK-ja dhe lidhej çështja për ndërtesat e banimit që duhet të plotësohen kriteret për personat me nevojë të veçanata dhe unë e dhashë si vërejtje që me pas parasysh ekipa hartuese, që ne nuk po flasim për ndërtesat e banimit por për ndërtesat industriale.

Urim Suka - siç e kemi thënë edhe më herët çdo përpjekje që zona të caktuar të krijohen hapësirë për zhvillim, ne i japim mbështetje dhe edhe kësaj mendojmë që duhet me i dhënë mbështetje mirëpo diskutimet tona janë në funksion të asaj që të jetë sa ma funksionale për të gjithë ata që dojnë me operu dhe mos me u kthyer sikurse ka ndodhur me praktikën e mëhershme në zonën industriale dhe agrozonën në Samadraxhë. E gjithë zona është në territorin e Bllacës dhe emrin e ka zona ekonomike në Duhël, është shqetësim i disa banorëve atje. Për deri sa kjo zona ekonomike ndërtohet në Bllacë dhe i frekuenton ata banorë, a keni menduar me mbajtë ndonjë dëgjim publik me banorët e zonës atje për veq dëgjimeve publike që i keni mbajtur me biznese? Gjithëashtu ta keni parasysh që në aspektin mjedisor me parapa edhe pjesën e gjelbërimit edhe përtej asaj që është kriter minimal ligjor.

Visar Kuçi - Plani rregullues i hollësishë në zonën ekonomike në Duhël i ka ndjek këto procedura: Pas miratimit të vendimit për iniciimin e këtij plani në këtë asamble është marrë ligjshmëria nga ministria, janë inicuar procedurat, është përzgjedhur operatori ekonomik dhe me vendim është formuar ekipi i cili e ka monitoruar këtë dokument. Janë mbajtur disa takime, janë caktuar tre skenarë dhe ekipi e ka miratuar njërin prej skenarëve ku e keni edhe te pjesa tekstuale dhe është mbajtur edhe një takim ku është prezantuar drafti. Drafti i këtij dokumenti përbëhet prej dy pjesëve, pjesës tekstuale dhe hastografike. Te pjesa tekstuale janë të sqaruara destinimet, vijat ndërtimore, vija rregulluese, zonat e të gjitha ato që janë planifikuar me ligj. Te pjesa Hastografike përbëhet prej 12 hartave, ku është pjesa e rrugës, pjesa e shfrytëzimit të tokës, ujësjellësi, kanalizimi. Ky plan rregullues sot ka ardhë në asamble për me marrë miratimin për shqyrtimin publik. Periudha minimum 30 ditë mund edhe ta zgjasim dhe për atë periudhë ne kemi me organizuar takime fillimisht me qytetarë të zonës dhe ekipi ka me i marrë kërkesat edhe të qytetarëve, edhe ato me shkrim dhe të asamblesë që u cekën më herët dhe nëse janë brenda ligjit dhe normave padyshim që kanë me u përmirësuar. Sa i përket pjesës së parkingjeve ose zonës për persona me aftësi të kufizuara ndoshta hartuesi e ka parapa që aty nuk ka vetëm zone industriale por ka edhe banim por nëse është për me u përmirësuar, patjetër që do të përmirësohet. Edhe ne si ekip i kemi vërejtur disa gabime siç u cek faqe 16.17.19 dhe besoj kanë me u përmirësuar në kohën e shqyrtimit. Sa i përket emrit

të zones, është fakt që zona kadastrale është në Bllacë por në të gjitha dokumentat edhe para këtij plani, është quajtur zona ekonomike në Duhël dhe nuk mund të ndryshohet tash sepse edhe në PZHK dhe HZK ka qenë kështu. Ju lus ta miratoni këtë dokument. Ju premtoj që një takim ka me mbajtje brenda 30 ditëve dhe vetëm me asambleista.

Sanie Kuçi Rexhepaj - në dokument nuk po ceket askund sipërfaqja totale e shfrytëzueshme për zonën ekonomike dhe mendoj që është shumë e nevojshme me pas në dokument.

Urim Suka - gjatë diskutimit drejtori e përmendi që ka edhe banim. Në çfarë kuptimi e the?

Visar Kuçi - e thashë në aspektin që nuk ka vetëm industri por ka edhe administratë dhe aty mund të punojnë edhe personat me aftësi të kufizuar.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ndoshta u keqkuptova por unë nuk e pata fokusin te personat me aftësi të kufizuara kur e thashë fjalinë por e pata kritikën që nuk ka objekte të banimit. Ndoshta mundet me qenë ndonjë hotel por prap ai nuk është banim por është çështje biznesi.

Visar Kuçi - unë të kuptova. Ka objekt të zjarrëfikësive, ka objekt komunal, ka me pas ndoshta qerdhe, objektet të shëndetësisë që ka mi frekuentu ato dhe ka me i plotësu normat.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Laureta Tafaj - dua të di nëse kjo parcelë është në listën e pronave që do të jepen këtë vit në shfrytëzim. Unë e kam potencuar në KPF dhe e them përsëri që pavarërisht që të gjithë fshatrat tona janë të gjelbëruara, unë gjithmonë do ti mbështes ato pika ku bëhet fjalë për më shumë gjelbërim, më shumë vende rekreative.

Mensur Selimaj - po, është kjo pronë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - në mbledhjen e KPF-së drejtor keni mungu edhe pse keni pika të rendit të ditës dhe po të jap kritikë drejtor që nëse vet nuk mund të jeni në mbledhje, të paktën delegone një zyrtar që të paktën me na dhënë sqarimet e nevojshme. Për shkak të mungesës së sqarimeve nuk kam qenë pro këtij projekt-vendimi por po provoj me i marrë informacionet nga drejtori. Kjo zonë në Leshan është e planifikuar për zonë rekreative dhe gjelbërim. Në kërkesën që e ke dorëzuar, keni potencu që ka kërkesa të vazhdueshme për me marrë në shfrytëzim këtë parcelë dhe unë dua ta di se për çfarë arsye ka me dhënë komuna në shfrytëzim, çfarë destinimi? Te pjesa e destinimit e keni cek që zona është edhe pjesërisht infrastrukturë rrugore por në anën tjetër ju e keni nda një pjesë të parcelës për me dhënë në shfrytëzim. Unë e shoh që në hartë është e destinuar për rrugë, një pjesë për rekreacion dhe gjelbërim por pjesa e parcelës që ju e keni skicu, kjo nuk është e planifikuar për infrastrukturë rrugore. Pse me dhënë në shfrytëzim edhe për infrastrukturë rrugore kur është e destinuar për rekreacion dhe gjelbërim. Mendoj që është e nevojshme infrastruktura rrugore me u largu prej projekt-vendimit sepse nuk kemi nevojë me dhënë në shfrytëzim për rrugë.

Mensur Selimaj - ne si drejtori dhe si komunë e kemi pa që me vendos në ankand publik për rekreativitet dhe e kemi nda për shkak se zona ka qenë afër rrugës.

Sanie Kuçi Rexhepaj - publikimi i listës në web faqe ju ka penalizuar për shkak se të gjitha parcelat që i keni publiku në faqe janë 15 deri 99 vite e në fakt zonat për përdorim të përkohshëm zakonisht janë shpall në ankande publike dhe jo konkurim të hapur dhe tash po na obligon në një formë që edhe zonat gjelbëruese me i dhënë në afatgjatë.

Kryesuesi - unë sa e kuptova drejtorin në aspektin që ka kërkesa të vazhdueshme, e merr në mënyrë të përgjithshme dhe jo vetëm për një parcelë.

Mensur Selimaj - çdo parcelë e komunës që është vjerrinë dhe është e mundëshme me u shfrytëzuar prej investitorëve që bëjnë kërkesë në drejtorinë tone, mendoj që duhet me nis procedure dhe me u zhvillu ajo pjesë ku kemi kërkesa si në këtë rast. Kemi kërkesë për plantazhe, kërkesë për rekreacione të tjera.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ne vazhdimisht kemi qenë mbështetës të pikave që kanë me u dhënë në shfrytëzim dhe muajin e kaluar na ka ardhë kërkesa në Bllacë për panele solare për energji por ka qenë e specifikuar mirë çështja për çka jeni duke e dhënë në shfrytëzim. Ne nuk jemi kundër që me u dhënë hapësirat në shfrytëzim por në anën tjetër nëse një parcelë është e destinuar për gjelbërim dhe fshati ka

nevojë për zonat rekreative publike,atëherë është potencial edhe i komunës për me investu aty dhe vetëm i palëve private.

Nexhat Ramadani - fillimisht dashta prap me përsërit një vërejtje që e kemi dhënë si grup parlamentar gjithmonë.Çdo pike që vie këtu është mire që paraprakisht që drejtori apo ata që e kanë sponzorizuar atë projekt-vendim,me dhënë sqarime dhe na kufizon edhe neve prej pyetjeve.Ne si grup parlamentar nuk jemi kundër sepse më mire me shfrytëzu dikush,me përfitu komuna dhe të zhvillohet një biznes se sa me mbet vjerrinë.Ajo që është shqetësuese për mua duket që çdo kërkesë që vjen aty,pa u analizu mirë menjëherë silllet në asamble.Kisha kërku prej drejtorisë që të bëhet një analizë më e sinqertë dhe të silllet projekt-vendimi këtu dhe fakti që ne kemi një varg të pronave që i kemi dhënë në shfrytëzim dhe shqetësuese është mbikqyrja dhe menaxhimi duke u nis prej zones industrial dhe shumë pronave tjera.Në një formë nganjëherë ngriti pykëpyetjen a me i votu këto edhe pse e di që është në interes të komunës shfrytëzimi i atyre pronave.Shqetësimi i dytë që kam lidhur me këtë prone është që kjo lagje është zgjeru shumë dhe në pjesën e vet nuk ka asnjë hapësirë publike tjetër për ndonjë nevojë të asaj lagje.Unë nuk jam kundra saj mirëpo është dasht me mendu me lënë një pjesë të saj si mundësi për ndonjë investim rekreativ kapital të komunës.Kjo po jepet për 30 vite dhe hapësira afër kësaj lagje për me bo një park të vogël ku mund të luajnë fëmijët nuk ka.Unë për këto i kam pikëpyetjet e mia dhe ndoshta nuk do ta votoj këtë projekt-vendim.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

23 për,2 apstenime, Miratohet pika 6

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen qytetar nderi;

Kryesuesi - kjo pike ka të bëjë me kërkesën e propozimit të ardhur nga grupi i qytetarëve të Suharekës të cilin e përfaqëson Destan Berisha nga Suhareka.Lënda e kërkesë për shpalljen qytetar nderi i komunës së Suharekës për z. Kastriot Bezatin.Kryesuesi lexon biografinë e personalitetit të z.Kastriot Bezaku sipas përshkrimit të grupit të qytetarëve të Suharekës.

Dardan Berisha - në parim e mbështesim këtë projekt-vendim. Qytetar nderi kur është shpall para dy viteve Shkurte Fejza,ne kemi pas diskutime dhe pakënaqësi brenda kuvendit komunal që kush do që shpallet qytetar nderi,me ardh m'u shpall këtu në kuvend ose në një ambient ku marrin pjesë të gjithë asambleistat dhe jo në një formë me privatizuar këtë ceremoni.

Nexhat Ramadani - nuk desha të diskutoj por me gjithë mirëkuptimin për ata që kanë marrë iniciativën,edhe kjo çështje ngapak sikur është bastardu.Nuk e njoh personin dhe nuk jemi kundër kësaj por mendoj që ngapak duhet me u analizu.Edhe çështja që tha Dardani unë pajtohem por këtu tash kanë me u marrë vendime dhe mundet me ndodh mos me u marrë vendimi dhe ai del në pozitë të keqe dhe pastaj bëhet ceremonia.Ne si grup jemi për por sikur po bëjmë gara këtu,emra me sjell dhe me shpall qytetar nderi.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 7.

Unanimisht Miratohet pika 7

Pika 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit lokal të veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunën e Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - besoj është obligim i komunës me miratu një plan veprimi të tillë dhe është mirë që të ketë plan veprimi. Është mire që personat përgjegjës që e kanë sjell këtë me na raportu me vitin paraprak ose vitet paraprake.A ka pas nevojë m'u implementu?A është ndonjë qytetar që ka përfitu nga ky plan?E mbështesim si plan veprimi.

Avni Btyqi - ky plan është hartu në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme pasi është obligim ligjor.Është zyrtari komunal për kthim dhe komunitete që është përgjegjës për këto çështje si dhe në kuadër të komunës është komisioni i themeluar për trajtimin e kërkesave,rasteve për personat e riatdhesuar.Nuk e di kohëve të fundit a ka pas kërkesa të tilla por mendoj që para liberalizimit të vizave ka pas vazhdimisht dhe komisioni i trajton kërkesat dhe i rekomandon Kryetarit të komunës që të merr vendim dhe ti ndihmohet atij personi të riatdhesuar që të integrohet në shoqërinë brenda territorit të komunës tonë.

Urim Suka - për deri sa ekziston një zyrtar që merret me këtë çështje dhe për deri sa ekziston një komision, është shumë e lehtë ne me pas edhe një lloj raporti karshi planit që na ka ardhë mbi gjendjen e kuzistuese deri tash.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 8.

Unanimisht Miratohet pika 8

Pika 9. Pyetje dhe përgjigje;

Besa Kuçi - në rrugën “Kadri Kokollari ” në lagjen Sllogja para një jave është bërë aksident duke i ik gropes të cilën e ka shkakto Hidroregjioni që ka sanu në atë pjesë. Është hera e tretë që Hidroregjioni aty intervenon dhe e dëmton rrugën dhe nuk e kthen në gjendjen e mëparshme. A është përgjegjësi e Hidroregjionit apo e komunës me i sanu këto probleme? Nga stuhitë e mëparshme që ishin në shkollat fillore në Gjinoc dhe shkolla e mesme dhe profesionale “Abdyl Ramaj” kanë pësuar dëmtime serioze të çatave. A është ndërmarrë ndonjë masë për renovim apo sanim të kësaj gjendje për shkak se me sa kam informacione asnjë hap nuk është ndërmarrë në këtë drejtim. Para dy-tre ditësh në rrugën e Shirokës nuk është identifikuar një pusët që nuk ka kapak dhe si pasojë e atij dëmtimi veturat kanë pësuar dëmtime. Nëse nuk mund të shkoni me i rregullu, të paktën sinjalizoni atë pjesë që ka defekte. Konkursi është hap dhe është mbyll për drejtor të QKMF-së dhe nuk e di a ka aplikuar dikush apo çka po bëhet? Aty sipas udhëzimit shkruan që duhet të jetë specialist i mjekësisë familjare. Në QKMF ka specialist por nuk konkurojnë. Pse nuk konkurojnë? Sepse klima është krijuar siç aty që kush të vjen thotë: unë çka të them. Aty duhet secili me kry punën e vet në bazë të detyrave dhe përgjegjësi që i ka. Një ndër kushtet po shkruan dhe gjithmonë ka shkruar që duhet t’i përgjigjet Drejtorit të DSHMS. Këto janë vërejtje të vazhdueshme që kanë qenë dhe janë dhe po pësojnë qytetarët sepse në momentin kur nuk menaxhohet mirë aty vazhdojnë edhe me drejtime tjera. Projekti Karitas ku punëtorët kanë mbetur 3 muaj pa paga, a ka shprehur që ato paga të paguhen? Më mirë përfundojë projektin dhe ata punëtorë shëndetësor le të drejtohen dikah. Ata e kanë dhënë një kontribut për këtë shtet dhe e bëjnë një punë të jashtëzakonshme dhe jemi krenu me ata infermierë dhe prap krenohemi. Gjithësesi është edhe detyrë e Kryetarit me bë një zgjidhje dhe pse jo edhe në asamble me gjet një zgjidhje që këta punëtorë mos të mbesin pa paga. Gjatë javës së kaluar janë nënshkruar shumë kontrata për banim social nga ministrja me Kryetarët e Komunave dhe vetëm komuna e Suharekës nuk ka përfituar. Pse nuk kanë përfituar? Sepse një kërkesë e tillë që është bërë gati dhe ka pas me nënshkru dhe me dërgu për Prishtinë, nuk e ka dërgu. Në këtë rast kanë humb qytetarët për shkak të neglizhencës së kabinetit të Kryetarit. Shfrytëzimi i veturave zyrtare, unë nuk e di veturat zyrtare si shfrytëzohen nga bashkëshort apo bashkëshortet e kabinetit të Kryetarit! Është shumë e turpshme.

Kryetari - te rruga Kadri Kokollari është e vërtetë që kompania është dasht me kthi në gjendjen e mëparshme. Kemi rast edhe para stadiumit të qytetit në Suharekë ku atë punë e ka bërë KEDS dhe e ka obligim me kthi në gjendjen e mëparshme. Përgaditjet për shkollat janë duke u bërë edhe sot. E kemi pothuaj një marrëveshje me MASHT për kompenzimin e komisionit i cili ka punë dhe besoj që shumë shpejt përfundon shkolla e Gjinocit dhe shkolla Abdyl Rama. Në Shirokë vet e kam njoftuar kompaninë që e ka mirëmbajtjen e rrugëve e cila është rrugë regjionale dhe është e vërtetë që puseta nuk funksionon te rrethi për Mushtisht. Te QKMF-ja është shpall konkursi disa here por nuk ka konkuru askush dhe Besa e din edhe ti që dallimi mes drejtorit të QKMF-së dhe specialistit është 100€. Sa i përket veturave zyrtare, punëtorët që janë të terenit mund të jenë edhe deri në ora 7:00 ose 8:00 dhe nuk kam informata dikush që e ka shfrytëzu por do ta shoh se kush e ka pas. Kemi shumë probleme të mëdha financiare ku vlera e Suharekës ka kaluar 10.5 milion euro dhe vetëm kohën e fundit janë marrë 500 mijë euro shërbime. Te shëndetësia kanë marrë mbi 270 mijë euro shërbime, te arsimit i kanë marrë mbi 30 mijë euro tash, te shërbimet publike kanë marrë. Ne kemi kërku në mënyrë zyrtare në bazë të kodit që na i kanë tërheq mjetet me na ndryshu projektet por nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga Ministria e Financave. Këto probleme i kanë pothuaj të gjitha komunat pa dallim partie politike. Si Kryetar i komunës, pa dallim partie politike ju ftoj njerëz në protestë në Prishtinë në ora 11:00. Nuk jemi kundër askujt por po shkojmë për me i mbrojtë interesat e komunave tona.

Amir Hoxha - Te rruga Kadri Kokollari për veq gropës sepse gropat ka gjithëandej dhe ndeshjet nuk shkaktohen veq prej gropave, është problem që nuk ka shenja sinjalistike të komunikacionit për shkak se rruga nuk është e përfunduar dhe e pranuar teknikisht. Aty banon edhe ti dhe ti e din që aty ikin disa shoferë pa patentë shofer për t’i ik policisë se janë rrugë më periferike dhe ndeshjet në atë udhëkryq

është e gjashta apo e shtata here që shkaktohen edhe kur s'ka qenë gropa aty. Gropa është shkakto prej Hidroregjionit dhe ka gropa gjithëandej që ata janë duke bërë përpjekjet e veta me i sanu defektet e veta të ujit dhe është problem i tyre dhe nuk është i drejtorisë tone. Te puseta në Shirokë, ne nuk kemi kontratë aktive për sanime dhe për kanalizime. Ne veq e kemi procedure dhe kur të lidhim kontratë merremi me ato kanalizime. Pa pas kontratë vet s'mund ta mbyllim atë punë.

Besa Kuçi - ne këtu jemi me i mbrojtë interesat e qytetarëve. Unë e thashë që nëse nuk keni kontratë, sinjalizone dhe është në rregull.

Flamur Bytyçi - ditë më pare e pashë që është vendos në tender rruga që lidhet me Reshtanin deri mbi fshatin Semetisht mirëpo nuk e keni parapa me bo një pjesë ku rrjedhin ujërat atmosferik. Shtrimi i kësaj rruge në këtë mënyrë besoj që është kot. Kam dëgju që e keni pranë edhe një kërkesë prej banorëve të fshatit Semetisht që me pas një trajtim të ujërave atmosferik. Kisha kërku nga Kryetari ta di se a ju keni përgjigj banorëve për këtë çështje dhe a do ta bëni këtë kërkesë që unë besoj që është shumë e drejtë. Unë kam fotografi që mund ti tregoj se çka ndodh kur ka reshje shiu dhe ka qenë edhe Visari në dëgjim publik ku e ka pa gjendjen e rrugës. Te pusetat edhe unë kam ankesë në dy lokacione ku njëra është në Shirokë të cilën e përmendi Besa dhe tjetra është në Studenqan te rruga që lidh fshatin Studenqan me zonën industriale. Këtu kemi marrë vendim për me rrit tarifën për mbeturina por nuk ka pas përmirësim të gjendjes sidomos gjatë verës. A ka pas efekt në ngritjen e pagave për punëtorët që punojnë në Ekoregjion. Pashë që tabelat informuese janë vendos në qytet dhe u befasova. Tabelat nuk janë vendosur ku lëvizin veturat por janë vendos me një anë që se kupton askush. Pashë një tabelë tjetër te ish Benafi ku shkruan anën e majtë qendra tregtare. Unë nuk besoj që duhet me vendos një table qendra tregtare kur ti veq je para një objekti por duhet me vendos 500 m ose 1 m më poshtë. Kërkoj nga drejtori m'i përmirësu këto tabela. Shqetësim tjetër është për pagat e punëtorëve që punojnë me Karitas dhe mendoj që është një neglizhencë e qeverisjes tuaj sepse ju e dini që ka me ndodh tërheqja e mjeteve prej përmbaruesit por kur i shoh disa shpenzime të kota tuajat, çoftë të naftës, drekave, dakave e organizimeve të ndryshme, mendoj që më e ndershme prej qeverisjes tuaj është me i ndal disa shpenzime e me i aloku për punëtorët shëndetësorë. Pyetja tjetër ka të bëjë me varrezat në Biraq. Kur do të lëshohen? Ku kanë mrrri punimet dhe çka ka me ndodh tutje? Ndriçimi publik është në gjendje tmerruese dhe më habit fakti pse nuk keni marrë masa deri tash. S'po foli për fshatra sepse ato janë në gjendje tmerruese por më shumë më ka interesu qyteti.

Kryetari - është e vërtetë që është hap projekti për rrugën Reshatn Semetisht. Është renovim i rrugës, nuk është ndërtim komplet i rrugës dhe së pari do të mbushen gropa e pastaj vendoset një shtresë asfalt. Kemi pas problem disa herë nga uji që vje prej lartë atje dhe ju e dini por ne do të mundohemi me bo punën më të mire të mundshme atje. Te mbeturinat, para disa dite kemi dërgu ndihmë prej kompanisë komunale, nuk ka punëtorë sepse nuk po dojnë me punu me atë page që e kanë. Në komunë ndërmarrja komunale startin e ka 600€ por besoni që ka dy here që shpallet konkursi dhe nuk dojnë me punu as me shkolla të mesme. Te kanalizimet, këtë vit e dini që buxheti ka ardhë me 2 prill dhe kemi pas procedura, janë hap oferta dhe dikush ka me marrë dhe intervenimet e para kemi me i bo aty ku ka nevojë më së shumti. Është rasti në Bllacë dhe Savrovë dhe disa fshatra që menjëherë duhet me marrë masa. Te problemi i varrezave, mjetet e varrezave i ka marrë kontrata kolektive dhe të shohim këtë vit a do të mundemi me vazhdu. Tre hektar janë gati. Unë kisha thënë me marrë një projekt që e kishin bërë Ferizaji. Sa i përket ndriçimit ju e dini që mjetet i ka marrë kontrata kolektive. I kemi vendos me shtesa dhe ka problem nëpër fshatra por jo si po e bëni ju dhe të gjitha do ti rregullojmë.

Visar Kuçi - është e vërtetë që operatori ekonomikë në shesh ka filluar me i vendos ato tabela dhe faktikisht nuk janë mire. Ata janë duke punu dhe ne kemi me i dërgu vërjetet për me i përmirësu dhe besoj përfundohen. Te rruga Reshtan-Nishor është fakt që në dëgjim publik kemi marrë pjesë ne të dy dhe atje qytetarët kanë kërkuar mos me i fut rrugët lokale në buxhet të vitit 2027 që të paktën të përmirësohen gropa. Ne veq e kemi marrë një projekt dhe vlera e atij projekti është shumë më e madhe se që e kanë kërkuar qytetarët për gropat dhe nëse është e mundshme pse mos me u rregullu edhe ato nëse janë brenda atyre pozicioneve që janë të parapara. Sa i përket varrezave ne e kemi pas disa here bisedë dhe faktikisht Kryetari është angazhu shumë për varrezat e qytetit por është angazhu edhe kryesuesi, edhe unë personalisht. Varrezat në qytet kanë probleme lagjet që janë të caktuara ku me i vorros anëtarët e familjes së vet. Siç e cekim edhe Kryetari 2 ha veq janë të gatshme për me i fillu vorrimet por ne e kemi diskutu edhe në bord që të bëhet një rregullore dhe të shkojnë me renditje dhe me parcela të ndara.

Flamur Bytyçi - më pëlqen ideja që me u bo një rregullore që me pas një renditje të mire edhe për pamje. Pres prej kabinetit qeveritar që me punu këtë rregullore dhe mos me leju me u varros dikush pa u bërë një rregullore.

Amir Hoxha - Sa i përket ndriçimit të kontrata e kaluar që është ndërpre janë hargju sasi të dhe e kemi diskutu disa herë. Tash paramasa e re është e kompletuar aq fortë dhe i ka gjithë elementet që e përbëjnë një ndriçim publik dhe është peshu si paramasë 80% në pjesën e funksionalizimit të ndriçimit ekzistues. Unë edhe herën e kaluar ju kam thënë që kjo për shkak të mirëmbajtjes ka mbetë kështu. Besoj sa ta kemi një kontratë kemi me pas të rregulluar këtë çështje.

Urim Suka - unë kam një shqetësim serioz. Dy pyetje unë i kam bërë muajin e kaluar dhe nuk kam marrë përgjigje. E para ka qenë që raporti me ardhë nga DKA-ja për procesin mësimor që është mbyll dhe për përgaditjet që janë bërë për fillimin e vitit të ri shkollor. Fakti që ju nuk i përgjigjeni një asambleisti edhe kur ai kërkon zyrtarisht diçka, është shqetësues dhe nuk duhet të ndodhë. Është edhe në plan të punës me raportu DKA-ja. Unë po e shtyej këtë pyetje për muajin e ardhshëm por le të ndodhë muajin e ardhshëm. E dyta ka qenë te Drejtorai e Bujqësisë ku unë kam kërku që a është ligjore marrëveshja që e keni lidh për trajtimin e qenëve endacak dhe nuk kam marrë përgjigje ende as sot. Nuk po kuptoj si po ju del transparenca 100% ku ju as zyrtarisht nuk përgjigjeni. U ngritën shqetësimet nga disa asambleist lidhur me problemin e kanalizimit por a e dini sa më shqetësoj përgjigja që morëm nga ju. Drejtori po thotë s'kam kontratë. Është 1 shtatori nesër dhe vetëm edhe 2 muaj ke drejtë me i shpenzu ato mjetet dhe ti ende s'ke kontratë për kanalizime. Unë prap kam një problem të ri të kanalizimit që njerëzit e kanë ngrit por s'e di si ka me u zgjidh kur ju s'keni kontratë ende. Në Sllapuzhan rruga kryesore "Komandant Xhavit" është blloku rrjeti i kanalizimit dhe ata kanë shqetësim. Kur pritet të bëhet kontrata dhe pasi ta bëni kontratën, Sllapuzhani, Bllaca dhe fshatrat tjerë a kanë me pas zgjidhje? Pyetja e dytë ka të bëjë me shëndetësinë. A po e kuptoni që po bëhen dy vite që ju s'keni drejtor në QKMF? Kur pritet me u bërë ai drejtor? Unë isha në QMF në Duhël dhe nuk kanë klimë atje. 39 gradë po shkon temperatura dhe i sëmuri duhet me nejt në ato temperature sepse ju si komunë nuk jeni në gjendje një klimë me vendos dhe është shqetësuese.

Kryetari - në momentin e pare që nënshkruhet kontrata, Savrova, Bllaca, Sllapuzhani. Ju e dini që s'kemi kompani për mirëmbajtje, ne ndërtojmë kanalizime të reja. Aty ku është sistemi i ujit që paguan faturën e ujit në fund të muajit, e ka edhe një taks që paguan për kanalizim por Sllapuzhani s'ka ujësjellës dhe ne detyrohemi tutje me intervenu. Te shëndetësia konkursi është shpall por s'ka konkuru askush sepse me konkuru, ne edhe me dasht nuk mund ta largojmë.

Liridon Fandaj - Kryetar thirrjen e fundit që e bërë për me dalë në protestë, a na tregon arsyt pse duhet me dale në protestë? Kur thua gjithë komunat kanë problem, problem kanë edhe komunat ku qeverisë LVV. Si ka mundësi ju me dale e ata mos me dalë? Del në media dhe thua që asnjëherë si më parë s'kemi pas investime prej kësaj qeverie. Ti po bën thirrje për me dalë në protestë dhe po bie në kundërshtim. Cila është arsyeja?

Kryetari - nuk jemi duke dalë për investime, jemi duke dalë për shkak të kompetencave të cinguar të komunës. Ka 9 muaj që nuk ka mundur ta jep askush provimin për me hy me punu në komunë që është shkelje e të drejtave. Është duke u punu ligji i ri për me u marrë kompetencat për pronat komunale. Punësimet i ka marrë, inspektorët sanitar i ka marrë, inspektorët e pyllit i ka marrë dhe në qoftëse i merr krejt atëherë ne duhet të shëmdrohem në bashkësi lokale. Edhe ne e dime që marrëveshjet për kontratat kolektive nuk i kanë bërë kryetarët e komunave por i ka bërë një ish qeverisje në të kaluarën me qeverinë dhe paratë është dasht ti paguajë qeveria e RKS-së dhe jo komuna. Gati ka mrri 10.5 milion euro. E pashë një postim ku ke thënë që tre muaj s'kanë marrë pagesë punëtorët por por kur e ke bo postimin vetëm një muaj janë kanë pa page. Ne e kemi një takim me ata qytetar, do të bisedojmë por unë e kam obligim me ia tregu realitetin si është pastaj ata le të vendosin punëtorët.

Liridon Fandaj - te ligji i shërbyesve civil ju e keni pas përfaqësuesin tuaj në kuvend kur ka kalu dhe u dasht atëherë me ngrit. Sot thirrjen e protestave nuk e jep me këto sqarime por më shumë për kontratë kolektive që vet e keni bo. Te pjesa e pronave, ende s'ka kalu.

Armend Krasniqi - edhe pse përgjigjen e keni marrë seancën e kaluar mirëpo sa i përket se kush i udhëheq procedurat e prokurimit, pasi që organizata në fjalë ka bërë subvencionimin e 51%, e ka marrë të gjithë kompetencën që të zhvillojë procedurat në atë kontratë të cilën e kemi lidhur. Ndërsa sa i përket Drejtorisë së Bujqësisë, DBZHR gjatë këtyre muajve të pare të qeverisjes ka kryer punë të jashtëzakonshme ku e ka kryer programin e subvencionimit të hapur nga ministria. 1600 fermerë janë kryer në drejtorinë tonë.

Urim Suka - ti nuk më dhe përgjigje. Unë kam thënë a është ligjore marrëveshja? Ti s'ke pas përgjigje, ke thënë ta sjelli me shkrim. Nëse s'ke përgjigje i drejtohem zyrtarit ligjor.

Avni Bytyqi - për deri sa nuk e kam pa marrëveshjen, nuk kam përgjigje.

Remzi Bajselmani - në plan të punës të DKA-së nuk kam pa që duhet me ardhë me i raportu kuvendit për punët që i kryen DKA-ja.

Urim Suka - në plan të punës së kuvendit figuron dhe çdo vit ka figuru por asnjëherë nuk ke raportu. Muajin e kaluar e kam kërkuar zyrtarisht një raport dhe në emër të grupit po e kërkoj një gjë të tillë prap.

Amir Hoxha - m'u drejtove që pse nuk ke kontratë. Kontrata do disa procedura. Janë disa procedura që i kemi realizu dhe e kemi vendos në prokurim publik. anë ofertu disa kompani dhe e lidhim kontratën

Liridon Fandaj - Drejtor i Pronës pse nuk kanë fillu procedurat për dhënien në shfrytëzim të deponisë së ngurtë në Shirokë pasi që ministria na ka kthi që nuk ka qenë e paraparë në listë në vitin 2025. A e ke parapa ti dhe pse nuk po jepet kjo deponi por po funksionon ilegalisht? Drejtor i Inspeksionit je edhe kryetar i fshatit Studenqan dhe ka shumë shqetësime që ajo deponi po përdoret jo për atë që është destinuar. Ka shumë mbetje tjera që nesër mundet me ndodh një sëmundje aty dhe me pësu qytetarët. Pse nuk del me pa dhe me qu në inspeksion dhe të paktën këtë pjesë me rregullu? Drejtor i Bujqësisë, e ke postu një thirrje por ka shkaktuar një huti te fermerët pasi këtu është DBZHHP skemën e mbështetjes. Ne te pagesat direkte, sidomos te pjesa e grurit, e viqave dhe zogjëve, i subvencionon ministria. Mua më kanë thënë plot fermerë që po subvencionon komuna, kërkoj sqarime.

Drejtor i Shërbimeve Publike ndriçimin e sqarove por është një shqetësim që pjesa prej rrethit këtu deri në hymje te Shiroka ndriçimi publik është dëmtuar dhe nuk funksionon por edhe disa kablllo janë nëpër tokë e që mundet me pësu ndonjë rrezik nëse ka kontakt. Ndoshta kompania që e mirëmban mundet me dal edhe me i pa ato që mos me bo ndonjë dëm edhe njerëzor. Drejtoria e Shëndetësisë: mungon shumë material shpenzues në QKMF dhe në AMF dhe po ashtu edhe departamenti i stomatologjisë nuk e ka një kontratë për furnizim me ndonjë operatorë tjetër dhe detyrohen ata vet me shku me marrë material në Prizren. A është problem i operatorit që nuk po e furnizon? Drejtoria e Arsimit: nesër fillon viti i ri shkollor, a janë të gjitha shkollat në gjendje me fillu procesin mësimor?

Gent Gashi - sa i përket deponisë është e vërtetë që është duke u shfrytëzuar edhe për mbeturina ose kocka të kafshëve. Ka qenë një kontratë e cila e ka bërë grupimin dhe ato i ka mbulu por tash ka skadur ajo kontratë. Këtë vikend që shkoi e kam marrë iniciativën, kam shku me firmën që e kam për kontratën e rrënimëve, i kam mbulu vet. Jemi në hulumtim me Drejtorin e Pronës për me gjet një parcelë se ku me bo varrezën e kafshëve.

Liridon Fandaj - ti e ke bo ndoshta edhe mbulimin e tyre por ajo deponi nuk është e destinuar për mbetje shtazhore, ajo është për mbetje të ngurta. Ti e paske bërë vet e jo duke iu referu ligjit dhe rregullores. Nesër me ndodh diçka është përgjegjësi e juaja si inspeksion që nuk e keni ndal.

Gent Gashi - unë sa e di ka qenë një kontratë me Fatmanin dhe Setin nëse nuk gaboj. Kanë pas që me i gju mbetjet. Tash jemi duke e kërku një parcelë.

Liridon Fandaj - je duke e thënë publikisht nëse ka një lloj kontrate. Unë po të them publikisht që s'ka qenë kurrë. Ajo është vetëm për mbetje të ngurta. Ditën kur i ka kalu kontrata ti është dasht me mbyll atë.

Armend Krasniqi - është e vërtetë që ka ekzistuar një kontratë 5 vjeqare për hudhjen e mbeturinave të ngurta. E kemi inicuar procedurën për dhënien në shfrytëzim për një afat 5 vjeqar dhe një afat shtesë e kanë kërkuar vet asambleistat për shkak se HZK-ja nuk e ka parapa ndonjë parcelë tjetër ku mund të bëhet hudhja e mbeturinave të ngurta. Sa ju kujtohet e kemi mbyll një javë ose dy javë dhe ka qenë tmerrësisht një gjë e keqe sepse kanë fillu nga një deponi me u bërë 50 deponi tjera. Është një pyetje e qëlluar sepse jam marrë shumë sa kam qenë drejtor dhe është detyrë e asambleistave që në mënyrë emergjente me gjet një vend ku duhet të hudhen këto mbeturina. Drejtori tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - drejtor unë iu drejtova Drejtorit të Pronës se ku është me procedura. Ti e ke sjell por ta ka kthi ministria sepse nuk e ke pas në listen e pronave për me dhënë në shfrytëzim.

Armend Krasniqi - drejtori jep sqarime sa i përket deponisë për mbetje të ngurta. Sa i përket pyetjes për thirrjen në Drejtorinë e Bujqësisë, në këtë muaj kanë ndodhur dy thirrje ku një thirrje është në kuadër të pagesave direkte të inicuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe thirrja tjetër është inicuar nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë në komunën e Suharekës. Tek e para kemi të bëjmë me tre sektorë ku kemi viqa për majmëri, zogj brojler dhe subvencionimin e

qumështit. Afati është deri me 3 shtator. Ndërsa tek thirrja e dytë e komunës është mbështetja apo subvencionimi i litres së qumështit.

Remzi Bajselmani - DKA ka punu gjatë tërë verës për përgaditjet e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore në komunën e Suharekës. Javën e kaluar me date 28 e kemi mbajtur mbledhjen me drejtorë të shkollave dhe është konstatuar që të gjitha shkollat do të fillojnë procesin mësimor ashtu si duhet. Mirëpo sot në mëngjes shkolla në Vraniq na ka njoftuar se nuk janë pastruar sa duhet dhomat e mësimi nga kompania dhe mund të shtyhet mësimi deri të mërkurën, maksimum deri të hënën. Edhe në Gjinoc janë duke u kryer disa punime në kulm, do të ketë vështirësi gjatë punimeve por kushtet janë për me u zhvillu procesi mësimor sepse brenda nuk ka asnjë punim.

Kymete Bajraktari - është evidente problemi me material shpenzues për shkak se ju e dini që përmbaruesi i ka marrë 270.000€ në QKMF prej mallrave dhe shërbimeve dhe e kemi të pamundur me u furnizuar me material shpenzues. Sa i përket barnave esenciale me të cilat furnizohemi prej ministrisë, gjithmonë na vijnë jo në afatin që i kërkojmë dhe na vijnë me mangësi. Te pjesa e stomalogjisë nuk mundemi me realizuar kontrata për shkak se janë marrë paratë e mallrave dhe shërbimeve.

Liridon Fandaj - shërbimin në QKMF duhet me krye jo me i marrë mjetet përmbaruesi të materiali shpenzues ku çdo qytetar ka nevojë. Po i merr mjetet në kodet ku i dërgon ZKF-ja dhe duhet ta keni parasysh këtë.

Kymete Bjaraktari - të njëjtin shqetësim e kam pas edhe unë dhe kam pyetur çka ka ndodhur. Mjetet kanë qenë të zotuar për kontratë për material shpenzues por sipas informatave që unë i kam marrë, ata nuk kanë pyetur dhe i kanë marrë të mallra dhe shërbimet. Të njëjtën kohë kemi bërë kërkesë për me i hequr tri projekte kapitale për renovime por nuk na është aprovuar kërkesa. Sa i përket klimave, është kontrata dhe disa drejtorë janë furnizuar me klima por problemin e kemi prap me para, atë mallra dhe shërbimet. Do të bëjmë diçka që sidomos nëpër QMF me dërguar nga një sepse e di që është problematike.

Amir Hoxha - shqetësimet për kabllo që bien rrugëve është përgjegjësi e KEDS dhe e operatorëve kabllo ku shumica prej tyre nuk kanë rrymë. Unë e kam inicuar një procedurë dhe i kam mbyllur të gjitha rreziqet që kanë qenë disa kabllo nëpër tokë e disa shtylla të ndriçimit publik që kanë qenë si rrezik.

Nexhat Ramadani - unë e shpërndava një hartë vetëm për kryetarët e grupeve parlamentare dhe qëllimi i saj është me treguar shqetësimet që i kemi pas çdo herë rreth mënyrës se si po shpenzohen mjetet për investimet kapitale, dhe kjo hartë ka të bëjë me Leshanin dhe investimet që janë në Leshan.

Në kohën kur ka qenë miratimi i KAB, kur e kemi diskutuar kanë qenë propozimet me emër ku dy rrugë kanë qenë segmente dhe unë kam kërkuar prej drejtorit që të shkojë ta shoh gjendjen reale dhe të vendosni aty ku është prioritet. Në hartën që e kam ndoshta ju i shihni, këto që janë me të kuqe janë dy rrugë të cilat janë në listen e investimeve kapitale dhe nëse i analizoni mirë e shihni që nuk ka asnjë shtëpi ndërsa poshtë të e kuqja është vetëm për një shtëpi. Rrugët që janë me të verdhë janë me nga 10 shtëpi dhe janë të vendosura me 50 vjet dhe nuk janë me prioritet sikurse që janë edhe rrugët tjera me të verdhë të cilat kanë qenë në listë të investimeve kapitale dhe kanë emërtim dhe kanë më shumë shtëpi. Këto që janë me të kaltër janë me nga 5-6 shtëpi, nuk kanë emërtim por janë shumë më me prioritet se rrugët me një shtëpi. Unë nuk po them që 100% çdo herë kanë m'u qellu investimet kapitale, ka prejashitje. Drejtor a të duket e drejtë, e ndershme dhe e sinqertë dhe a është investim i duhur ky? A duhet me shkuar kështu investimet kur njerëzit janë të barabartë dhe paguajnë taksa rregullisht aty?

Amir Hoxha - kur ma ke sugjeruar në fillim të mandatit kur kam filluar që duhet me dale dhe me i pa vet arsyeshmërinë e këtyre investimeve, tu kam përgjigjur saktësisht se këto kanë qenë kërkesat e kryesive dhe nuk kam qenë aty për me i pa sa janë të arsyeshme këto dhe kemi vazhduar ashtu. Kur kemi zhvilluar punime në teren e kam menduar dhe e kam thënë që ka qenë e arsyeshme kërkesa dhe sugjerimi yt sepse beso ose jo unë kam hasur në problematika shumë të mëdha në një fshat të madh dhe aty qytetarët, nxënësat nuk kanë ka shkojnë në shkollë sepse urën e kanë të dëmtuar dhe kryetari fshatit i cili është partisë tënde kërkon një rrugë x për mi marrë disa vota apo ku ta di unë pse. Kjo ka qenë ajo arsyeshmëria e asaj që ke thënë në fillim të mandatit dhe e kam menduar që duhet me dale vet për me pa arsyeshmërinë e këtyre investimeve. Pajtohem në shumicën e rasteve që ke thënë mirëpo gjatë realizimit të punës të premtosh që nëse veq ka me marrë pjesë në realizim të këtyre punimeve, ka me pa edhe një herë arsyeshmërinë dhe me vendosur në ndikimin tim si drejtor për shkak të çështjes të mirëfilltë publike ndërsa për këto që i analizuat tani, të kam dhënë përgjigje herën e kaluar.

Nexhat Ramadani - unë nuk kam kërkesë individuale dhe rrugët janë duke u punuar aty dhe le të vazhdojnë, s'ka problem. Dua ta kuptoni që kërkesat dhe sugjerimet tona janë të sinqerta.

Qëndrim Elshani - tash më e dime që ministria veq sa ka filluar nënshkrimim e marrëveshjeve për banim social adekuat e cila është një mundësi shumë e mire për familjet në nevojë. Siq e dime komuna e Suharekës nuk ka aplikuar fare.Për deri sa komunat tjera po sigurojnë investime për banim social,qytetarët e Suharekës nuk kanë as mundësinë të përfitojnë sepse pushteti lokal këtu nuk e ka marrë as mundimin e guximin për me apliku.Pse Suhareka nuk ka apliku?

Kymete Bajraktari - e kemi diskutu dhe jam interesu. Kur kam bisedu me Kryetarin,Kryetari ka thënë që i kemi ndërtu 150 shtëpi me donator që janë raste sociale.Ndërkohë kam bisedu me drejtorë të mirëqenies sociale të komunave tjera dhe ata e kanë dhënë një fitbek jo të mire.Kanë thënë që ato ndërtesa janë shëndrru barrë për komunat për shkak se mirëmbajtja dhe rastet të cilat janë të vendosura aty janë katastrofë.

Qëndrim Elshani - këto banesa nuk janë vetëm për raste sociale por quhen edhe si banesa për banim të papërbalueshëm.

Liridon Fandaj - komuna e ka një vend të ndarë,kështu është përgjigj nënkryetarja e mëhershme por nuk kanë apliku.Drejtori i shërbimeve Publike në atë kohë përgjigjen që ma ka dhënë mua,ka thënë që s'kemi mendu që e fitojmë ne si projekt.Nevojë ka boll sepse vetëm me vendos një shpallje aplikojnë plot qytetar që kanë nevojë për banim sepse të paktën nuk jeton me një bashkësi familjare prej 20 vetave por del vet dhe e ka të përbalueshme atë.

Kymete Bajraktari - kemi raste te bonus banimi të cilët janë duke aplikuar dhe mendoj që kjo pak e zbut këtë.

Takimi përfundoi: 11:45

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj

Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec Bexhet Kuçi